РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr_______

________г./v.

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-5271/1 i datës 27.05.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi t'i përcillet Inspektoratit Shtetëror të Punës të RMV-së dhe inspektorit të autorizuar të mjedisit në Komunën Qendër.

Lënda me numër 12-5271 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5271/1të datës 20.07.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e bëra në denoncim kanë të bëjnë me veprime të paligjshme të klubit //në //, të cilat nuk përputheshin me ligjet e marrëdhënieve të punës, përsa i përket orarit të punës dhe mbrojtjes së mjedisit, përsa i përket volumit të zërit. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Autoriteti kompetent për shqyrtimin e pretendimeve në denoncim në lidhje me mosrespektimin e orarit të punës është Inspektorati Shtetëror i Punës i RMV-së, dhe autoriteti kompetent për të shqyrtuar dyshimet në lidhje me volumin e zërit është inspektori i autorizuar mjedisor i Komunës Qendër. Prandaj, KSHPK-ja e konsideron të nevojshme t'ua përcjellë kërkesën këtyre autoriteteve.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: N.B.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska